

RREZIKUNGA VIRUSI

SITUATA

Rreth 1800 raste ditore, shifra më e lartë që nga fillimi i pandemisë

“Omicron” bën kërdinë, Komiteti: Forconi zbatimin e masave


Rriten shumëfish infektimet, por asnjë kufizim shtesë. Manastirliu: Vaksinimi dhe doza përforcuese, domosdoshmëri

TIRANE

Ndërkohë që mutacioni i Covid-19 “Omicron” po mbizotëron në vendin tonë me infektimet në masë në ditët e para të janarit, Komiteti Teknik i Ekspertëve është mbledhur për të kërkuar zbatimin rigoroz të masave në fuqi, por pa shtuar asnjë të re, pavarësisht rritjes disafish të infektimeve.

Pas mbledhjes së zhvilluar pa praninë e medias, ministria e Shëndetësisë, Ogerta Manastirliu, ka komunikuar vendimin, ndërsa u ka bërë thirrje qytetarëve të zbatojnë masat aktuale. Maska është e detyrueshme në ambiente të mbyllura, lëvizja e qytetarëve dhe aktivitetet lejohen deri në orën 23.

MANASTIRLIU
Gjatë diskutimit të situatës në tryezën e ekspertëve të shëndetësisë, ministria theksoi dy gjëra: zbatimin rigoroz të masave dhe vaksinimin. “Komiteti Teknik i Ekspertëve është duke ndjekur në vazhdimësi situatën, duke e ndjekur në dinamikë atë, duke vlerësuar të gjithë indikatorët epidemiologjikë. Duke vlerësuar sigurisht edhe masat aktuale. Ndaj apeli është zbatimi i masave të cilat janë në fuqi, dhe sigurisht, më pas duke vlerësuar në mënyrë dinamike situatën epidemiologjike, do të rivlerësojmë padyshim nëse do të ketë nevojë edhe masat aktuale që kemi”, vuri në dukje nr. 1 i shëndetësisë, duke shtuar se doza e tretë është domosdoshmëri, veçanërisht për të shmangur format e rënda të sëmundjes dhe fatalitetet, në kushtet e përhapjes në vendin tonë të dy varianteve: “Delta” dhe “Omicron”. Nga ana tjetër, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor këto ditë ka bërë një verifikim në më shumë se 500 institucione shtetërore, nga ku rezultojnë se rreth 80 për qind



Nga mbledhja e djeshme e Komitetit Teknik të Ekspertëve

Më të prekura moshat aktive, 25-45 vjeç

“Fluturimi” i shifrave të infektimeve përgjatë ditëve të fundit, sipas mjekëve epidemiologë, është i pritshëm, me depërtimin e dy varianteve lehtësisht të përhapshme dhe festave që bëjnë bashkë shumë familjarë. Por ajo çka vihet re më së shumti janë moshat aktive më të prekura. “Ishte e pritshme një trend në rritje i numrit të rasteve me të dhënat paraprake që variant ‘Omicron’ nuk është aq agresiv dhe i ashpër sa ‘Delta’, por transmetueshmëria e tij është më e lartë. Grupmosha mbizotëruese është ajo aktive, 25-44 vjeç, e ndjekur nga mosha 44-60 vjeç. Varianti ‘Omicron’ po bëhet dominues ndaj vaksinimi po merr rëndësi më të madhe me qarkullimin e tij, si dhe respektimi i masave”, thotë Artan Simaku nga ISHP, teksa nënvizon se ndonëse situata aktuale në spitale është e qëndrueshme, nuk përjashtohet mundësia e rëndimit të situatës së hospitalizimeve.

e punonjësve janë vaksinuar. Mbulësia vaksinale është pak më e ulët te punonjësit e supermarketeve apo në qendra tregtare, rreth 70 për qind. Që prej fillimit të vaksinimit në janarin e shkurtit, në vend janë injektuar rreth 2.5 milionë doza vaksinash anti-Covid. Ditët e fundit numri i vaksinimeve ditore është rritur ndjeshëm, duke krijuar edhe radhë të pikat e vaksinimit.

SITUATA

Dje Shqipëria vendosi një rekord të ri infektimesh, me 1781 raste të reja, shifra më

e lartë e regjistruar që nga fillimi i pandemisë. Në harkun kohor të pak ditëve, shifrat janë dyfishuar dhe kanë ardhur në rritje progresive. Por ende nuk është ndjerë impakti i situatës së rëndë të infektimeve në masë të spitalit, e madje, as në fatalitete. Për fat të mirë, ditën e djeshme nuk është shënuar asnjë viktimit nga Covid-19. Në të vetmen strukturë shëndetësore për trajtimin e pacientëve, Spitalin Infektiv, po marrin shërbim 111 qytetarë, 12 prej të cilëve në gjendje të rënduar.

COVID-19 - STATISTIKA

Raste të reja ditore	1,781
Të shëruar në 24 orë	278
Të shtruar në spitale	111
Humbje jete në 24 orë	0
Testime ditore	8,105
Testime totale	1,516,613
Raste pozitive	216,686
Raste të shëruara	202,664
Raste aktive	10,789
Humbje jete	3,233

SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE E RASTEVE AKTIVE SIPAS QARQVEVE:

Tiranë	5,155	Berat	380
Fier	1009	Gjirokastrë	392
Durrës	914	Lezhë	308
Elbasan	757	Korçë	261
Shkodër	690	Dibër	145
Vlorë	688	Kukës	90

80



PËR QIND e punonjësve të administratës shtetërore thuhet të jenë vaksinuar, sipas të dhënave të mbledhura pas datës 4 janar, kur vaksinimi u bë i detyrueshëm për këtë kategori, pas bluzave të bardha, mësuesve, universiteteve

2.4



MILIONË vaksina janë kryer në vend në harkun kohor të një viti, por më pak se gjysma e popullsisë së Shqipërisë rezultojnë të ketë kryer së paku një dozë. Sipas Ministrisë së Shëndetësisë, 1.1 milion qytetarë kanë injektuar një vaksinë

REPUBLIKA E SHQIPËRIË

SHPLLJE VENDE TË LIRA PUNE

Me mbështetjen e Programit të Konverimit të Borxhit për Zhvillim IADSA II, Bashkia Berat është duke krijuar Qendrën Rinore Multi-funksionale si një model për të zhvilluar dhe fuqizuar fëmijët dhe të rinjtë në qytet për tu bërë qytetarë aktivë me aftësi shumë-planëshe për të përcaktuar strategjitë e tyre të jetës dhe për të arritur sukses.

Në këtë kuadër, në bazë të Marrëveshjes së Shkëmbimit të Borxhit Italo-Shqiptar IADSA II me nr. 3628 Prot, datë 30.07.2020, si dhe sipas pikës 12.7 të Udhëzimit për Zbatimin e Projektit (GPD), ligjin nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” Bashkia Berat kërkon të punësojë me kohë të plotë dy punonjës për një periudhë deri në 5 muaj me mundësi të shtyjes së këtij afati.

a) Një Drejtues/Administrator për Qendrën Rinore Multifunksionale Berat
b) Një Receptionist për Qendrën Rinore Multifunksionale Berat

Përshkrimi punës: Drejtues/Administrator për Qendrën Rinore Multifunksionale Berat

1. Drejtuesi do të jetë përgjegjës për ideimin dhe menaxhimin e organizimit të aktiviteteve;
2. Bashkëpunimin dhe koordinimin me institucionet publike dhe palet të treta;
3. Do të shërbejë si pikë kontakti dhe bashkëpunimi me përfaqësues të pushtetit vendor sipas target-grupit;
4. Menaxhimin dhe drejtimin e të gjithë grupeve të qendrës multifunksionale;
5. Përgjegjës për menaxhimin, mirëmbajtjen e infrastrukturës dhe pajisjeve në të gjithë qendrën;
6. Përfaqësues zyrtar i qendrës në nivel institucional, që mban kontaktet për nisim të ndryshme lokale, rajonale, kombëtare e më gjërë;
7. Përgjegjës për implementimin e politikave dhe strategjive të pushtetit vendor e qendror;
8. Do të jetë përgjegjës për menaxhimin e të gjithë hapësirave me projektim të posaçëm të qendrës, menaxhimin dhe koordinimin e të gjithë aktiviteteve të organizuara në qendër.

Përshkrimi punës Receptionist për Qendrën Rinore Multifunksionale Berat

1. Receptionisti do të jenë përgjegjës për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të qendrës Multifunksionale;
2. Menaxhimin e ambienteve të Qendrës Multifunksionale.
3. Krijimi dhe përditësimi i një databazë për aktivitetet dhe klubet e krijuara.
4. Përgjigja e telefonatave/emailsve me kërkesë për informacion etj.
5. Ofrimi i informacionit për orientimin e duhur në godinë.

Shënimi: Dokumentacioni për detyrat specifike të secilit pozicion si dhe kërkesat dhe kushtet e veçanta që duhet të plotësojnë kandidatët janë të disponueshme në faqen zyrtare të Bashkisë Berat <http://bashkiaberat.gov.al/shpallje-per-pozicione-te-lira-pune>. Kandidatët duhet të dorëzojnë me postë në sekretarinë pranë Bashkisë Berat, dokumentacionin e kërkuar brenda datës 09.02.2022. Për çdo pyetje, ju lutem të kontaktoni në adresën e e-mailit të bashkisë Berat info@bashkiaberat.gov.al.